



A.nr.340/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani, kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti, anëtar, me Rushit Kajtazi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr. 340/2026, të datës 24.03.2026, të parashtruar nga ankuesi I.K, kundër organit të punësimit: Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, në çështjen juridike “Vlerësim i Rezultateve të Punës”, në mbështetje të nenit 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenit 16, paragrafi 3, dhe nenit 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.07.2026, mori këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** si bazuar ankesa me numër A.nr. 340/2026, e datës 24.03.2026, e parashtruar nga ankuesi I.K.
- II. **Anulohet** Formulari për Vlerësimin e Rezultateve në punë për ankuesin I.K, për vitin 2025 i datës 25.02.2026, i nxjerr nga Drejtori i Përgjithshëm i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore ndërsa, çështje kthehet në rishqyrtim dhe rivlerësim tek organi i njëjtë.
- III. **Obligohet** Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore, të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme administrative për rivlerësimin e ankuese, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimin të tij.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim për veprimet e ndërmarra.

A r s y e t i m

Ankuesi I.K, (me tej referuar vetëm ankuesi), më datë 24.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjën A.nr.340/2026, kundër Vlerësimit të Rezultateve në punë për vitin 2025 të datës 25.02.2026, të nxjerr nga Drejtori i Përgjithshëm i Këshillit të Kosovës për Trashëgimia Kulturore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave,

me datën 01.04.2026 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, ndërsa kjo e fundit, më datë 30.04.2026, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin në vijim Kolegji i Këshillit)

administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1476/2026 të datës 24.03.2026 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raportin e punës nga muaj janar i vitit 2025, deri në muajin dhjetor të vitit 2025; Emalin e datës 16.01.2025, të dërguar nga I.K; Emalin e datës 06.05.2026; Emalin e datës 06.05.2026 dërguar nga K.B; Emalin e datës 14.11.2025, dërguar nga I.K; Emalin e datës 17.12.2025, dërguar nga I.K; Shkresa e datës 28.07.2021; Emalin e datës 06.05.2025, dërguar nga K.B; Kopje e pasaportës për ankuesin; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 01.04.2026, e dërguar nga R.K, për K.B; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 340/2026 e datës 30.04.2026; Formularin për Vlerësimin e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2025; Plani i Performancës; Akt Emërimi i datës 30.08.2022, për ankuesin I.K.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur së ankesa e ankuesit është e bazuar.

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesi sipas Akt Emërimit AE. Nr. 01/2022, të datës 03.08.2022, është i punësuar në pozitën “Udhëheqës i Divizionit Programit për Mbrojtën e Trashëgimisë Kulturore Materiale”, në kategorinë Drejtues i Ulët, në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore.

Me tej, Drejtori i Përgjithshëm i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, me datën 25.02.2026, ankuesit i ka bërë vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2025, duke e vlerësuar me notën e përgjithshme 1.26.

Ankuesi, I.K, i pakënaqur me Vlerësimin e rezultateve në punë, të bërë Drejtori i Përgjithshëm i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, me datën 24.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se me datën 25.02.2026, Drejtori i Përgjithshëm i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore dhe se në këtë email ku me fton lidhur me rezultatet në punë për vitin 2025 dhe se në këtë email nuk është bashkangjitur fare vlerësimi që unë të kem mundësi të shoh dhe të jepe komente dhe në të njëjtën ditë i kam dërguar email duke kërkuar sqarime se në çfarë orë dhe çfarë ditë të me ftoni në takim për të diskutuar kundër vlerësimit të rezultateve në punë dhe se me datën 16.01.2025, kam pranuar një email nga F.S, të cilën e kishte të bashkangjitur draft Rregulloren e Sistematizimit ku kërkohej që rekomandimet të dërgohen deri me datë 21.01.2025 dhe me datën 21.01.2025 se bashku me koleget i kemi përgatitur rekomandimet dhe kemi dhënë konkrete dhe kemi dhënë sugjerimet tona në lidhje me këtë rregullore me tej ankuesi pretendon që Këshilli të aprovojë ankesën e ankuesit si të bazuar të anulojë formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2025, dhe të ndryshohet formularin i vlerësimit dhe të behet nota e përgjithshme mbi 3.5. Kolegji ju referua Ligjit Nr.8/L-197 për Zyrtarët Publik gjegjësisht Neni 52 paragrafi 1,2,3 nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.3 si dhe paragrafit 4,5,6 nën paragrafit 6.1,6.2 dhe paragrafit 11 ku përcaktohet se “Vlerësimi i rezultateve në punë 1. *Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunës/it civil në realizimin e objektivave dhe*

përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësi të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të përcaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunëses/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil. 6. Procedura e vlerësimit të rezultateve në punë përfshin dy (2) faza kryesore: 6.1. mbikëqyrjen e vazhdueshme të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë; 6.2. vlerësimin vjetor të rezultateve të punës nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore. 11. Mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë gjatë procesit të vlerësimit është e/i obliguar të vlerësojë nëpunësen/in në mënyrë objektive dhe të argumentojë vlerësimin, ndërlidhur me nenin 9, paragrafi 1, nen paragrafi 1.1.1.2, 1.3., 1.4. të Rregullores (QRK) NR. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, 11 ku përcaktohet se; 1. Nivelet e vlerësimit të rezultateve në punë janë: 1.1. arritje e jashtëzakonshme; 1.2. tejkalon pritshmërinë; 1.3. arrin pritshmërinë; 1.4. ka nevojë për përmirësim; 1.5. e papranueshme.

Bazuar në konstatimet si me lartë, Kolegji i Këshillit, konstaton se vlerësimin i rezultateve në punë për ankuesin është bërë edhe në kundërshtim me nenin 15, paragrafi 1 nen paragrafi 1.2 të Rregullores (QRK) Nr. 26/2024 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë, ku përcaktohet se; 1. *Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohen: 1.1. Rregullorja Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimit Publikë*, prandaj kolegji konstaton se Drejtori i Përgjithshëm i Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore, vlerësimin e rezultateve në punë nuk e ka bërë ashtu siç e përcaktojnë dispozita e lart cekura që kanë qenë në fuqi, në periudhën për të cilën ka qenë në fuqi Rregullorja për Vlerësimin e Rezultateve në Punë

Përpos që Drejtori i Përgjithshëm proceduralisht ka zbatuar të drejtën materiale gabimisht, në të njëjtën kohë ka qenë e pa mundur të bëhet vlerësimi i drejtë dhe i saktë i ankuesit, sepse nga shkresat e lëndës konstatohet se pretendimi i ankuesit se Drejtori i Përgjithshëm nuk përcaktuar objektivat individuale është i bazuar në ligj, andaj me këtë veprim Drejtori i Përgjithshëm në KKTK ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr.08/L-197 për Zyrat e Publik respektivisht nenin 52 ku përcaktohet se “ Vlerësimi i rezultateve në punë 1. Vlerësimi i rezultateve në punë është proces i vazhdueshëm, që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave të paracaktuara, vlerësimin e aftësisë profesionale, metodologjike, personale dhe sociale të nëpunëses/it civil në realizimin e objektivave dhe përmbushjen e përgjithshme të përgjegjësi të njësisë. 2. Periudha e vlerësimit zgjat një (1) vit, nga 1 janari deri me 31 dhjetor. Procedura e dhënies së vlerësimit përfundon deri më 28 shkurt të vitit pasues. 3. Vlerësimi i rezultateve në punë bazohet në: 3.1. realizimin e objektivave të përcaktuara në planin vjetor individual, përmbushjen e detyrave të punës në përputhje me përshkrimin përkatës të punës, objektivat e njësisë dhe institucionit, si dhe kryerjen e detyrave të atypëratyshme që nuk janë paracaktuar paraprakisht apo

nuk kanë mundur të paracaktohen; 3.2. aftësitë profesionale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës, si dhe sjelljen profesionale; 3.3. aftësitë metodologjike, personale dhe sociale të shfaqura nga shërbyesja/i civil gjatë ushtrimit të detyrës. 4. Përcaktimi i objektivave individuale të nëpunëses/it civil bëhet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë në bashkëpunim me nëpunësen/in dhe përfaqësuesen/in e njësisë së burimeve njerëzore, me shkrim, në muajin janar të çdo viti, së bashku me planin individual të punës për arritjen e këtyre objektivave. 5. Plani individual i punës i përcaktuar në paragrafin 4. të këtij neni, mund të rishikohet nga mbikëqyrësja/i i drejtpërdrejtë dhe përfaqësuesja/i i njësisë së burimeve njerëzore, në bashkëpunim me nëpunësen/in civil.

Prandaj, Kolegji obligon Drejtorin e Përgjithshëm në Këshillin e Kosovës për Trashëgimi Kulturore të Kosovës që në rivlerësim të respektoj të gjitha hapat ligjor lidhur me vlerësimin e ankuesit, sepse siç është thënë më lartë në këtë arsyetim, Drejtori ka përdor formular jo zyrtar në vlerësim, gjithashtu, nuk ka respektuar hapat ligjor, prandaj me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, Kolegji ka vendos që lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivlerësim tek organi i njëjtë.

Theksuar si më lartë, Kolegji i Këshillit konstaton së pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara, dhe si rrjedhojë duke u bazuar nënin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 dhe nënin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

LËNDA, A.nr. 340/2026

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

Ankuesit, I.K;

Udhëheqësit të Njësisë së Burimeve Njerëzore dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore; si dhe,
Arkivit të KPMSHCK-së.